



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansije i Transfere - Ministry of Finance and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



UDHËZUES PËR PAGESË SHITESË TË PUNËTORËVE TË RREZIKUAR NGA KONTAKTI I DREJTPËRDREJTË ME KONSUMATORIN

Prill 2020

Përmbajtja

1.Hyrje.....	3
2.Kërkesa për pagesë shtesë për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe barnatoreve	3
SHTOJCA 1 – INFORMATA SHITESË	8

Lista e figurave

Figura 1:Mënyja për kërkesë për pagesë shtesë për punëtorët e rrezikuar	3
Figura 2:Faqja për kërkesë për pagesën shtesë.....	4
Figura 3:Tabela në formatin Excel për plotësimin e të dhënave për të punësuarit e rrezikuar	4
Figura 4:Faqja gjatë procesit për kërkesën për pagesë shtesë për punëtorët e rrezikuar	5
Figura 5:Konfirmimi i kërkesës të regjistruar me sukses	6
Figura 6:Kërkesa për pagesë shtesë për punëtorët e ekspozuar ndaj rrezikut, e shkarkuar me shtypjen e butonit "Shtyp Kërkesën"	7

1.Hyrje

Ky udhëzues shërben për të gjithë tatimpaguesit, të cilët kanë pasur ndikim negativ nga situata e emergjencës shëndetësore me vendimet e Qeverisë së Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, me ç' rast ju nevojitet kërkesa për pagesë shtesë për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave të bukës dhe barnatoreve (të ekspozuar drejtpërdrejtë ndaj klientëve) sipas Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente – COVID-19.

Fillimisht shfrytëzuesi duhet të ketë llogari të hapur në EDI (Shërbimet elektronike/EDI-Deklarimi elektronik), në mënyrë që të kyçet dhe të ketë mundësi që t'a bëjë kërkesën në fjalë.

Në vazhdim janë shpjeguar hap pas hapi udhëzimet e nevojshme për ta bërë kërkesën për pagesë shtesë të punëtorëve, të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me konsumatorin gjatë punës së bërë.

2.Kërkesa për pagesë shtesë për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave të bukës dhe barnatoreve

Për të bërë kërkesën për pagesë shtesë për punëtorët të rrezikuar nga kontakti i drejtpërdrejtë me konsumatorin, shfrytëzuesi duhet të navigojë tek menyuja Shërbimet/Kërkesë për Punëtorët e Rrezikuar (e shënjuar me ngjyrë të kuqe), sikurse në figurën vijuese:




Figura 1:Menyuja për kërkesë për pagesë shtesë për punëtorët e rrezikuar

Në këtë rast hapet faqja, ku mund të bëhet kërkesa në fjalë:




Figura 2: Faqja për kërkesë për pagesën shtesë

Fillimisht shkarkohet mostra duke klikuar në butonin “Shkarko Mostrën” dhe mostra e shkarkuar (në formatin Excel), duhet të plotësohet me kujdes.


Nr	Emri	Mbiemri	Numri Personal	Pozita e punës me rastin e ekspozimit/kontaktit ndaj klientëve	Shuma për kompensim (Neto)	Banka	Logaria bankare

Figura 3: Tabela në formatin Excel për plotësimin e të dhënave për të punësuarit e rrezikuar

Për vëmendjen tuaj gjatë plotësimit të listës së punëtorëve:

1. Para plotësimit të listës së punëtorëve, duhet pasur parasysh se në bazë të vendimit të Ministrisë së Financave dhe Transeferëve, për Pakon Fiskale Emergjente, personat të cilët do të përfitojnë sipas Masës 7, në kolonën “Shuma për kompensim”, u vendoset vlera 100€.
2. Gjatë plotësimit të informatave për punëtorët, duhet pasur kujdes sepse çdo mospërputhje /pasaktësi e numrit të letërnjoftimit dhe numrit të xhirollogarisë bankare rezulton me pamundësi të ngarkimit të Excel fajllit në formular, si dhe ekzekutimit të mjeteve financiare në llogarinë e punëtorit përkatës.

Për të krijuar një kërkesë të re, shtypet në butonin “Kërkesë e Re”, me ç’rast edhe hapet faqja ku shfrytëzuesi duhet ta plotësojë kërkesën (shih në figurën 4 fushën e shënjuar me ngjyrë të kuqe), duke ngarkuar Excel fajllin e plotësuar (nga fig.3) me punëtorët për të cilët nevojitet/kërkohet pagesa shtesë prej 100€.



The screenshot shows the website of the Tax Administration of Kosovo. The header includes the logo and name in Albanian, Serbian, and English. The main navigation menu contains: Ballina, Deklaratat, Raportet, Sherbimet, Profili, Ndhimë, and Kontakti. Language options are ALB, SRB, and ENG. The page title is "Kërkesë për shtesë të punëtorëve të ekspozuar ndaj rrezikut". The form fields are: Numri Fiskal (601138177), Emri i tatimpaguesit (TEST CORP), Adresa e tatimpaguesit, and Zgjedh Excel listën (Choose File | PayrollExTe...ate_AL.xlsx). Below the fields are two red warning icons with text: "Deklaroj se biznesi është aktiv gjatë muajve Mars - Prill 2020 dhe ushtron veprimtari afariste, si: dyqan ushqimor dhe/ose furrë buke dhe /ose barnatore." and "Deklaroj se punëtorët në listën e deklaruar janë në kontakt të drejtpërdrejtë me konsumatorin gjatë ushtrimit të aktivitetit në vendin e tyre të punës." At the bottom are three buttons: "Dërgo listën" (green), "Shkarko Mostrën" (blue), and "Anulo" (red).

Figura 4: Faqja gjatë procesit për kërkesën për pagesë shtesë për punëtorët e rrezikuar

Ngarkohet Excel fajlli me të dhënat e plotësuara dhe plotësohet fusha e komentit në lidhje me vështirësitë financiare të tatimpaguesit.

Shtypet në butonin “Dërgo listën”, dhe hapet faqja ku confirmohet se kërkesa është regjistruar me sukses:




Figura 5:Konfirmimi i kërkesës të regjistruar me sukses

Në figurën 5, shfaqen butonat “Shtyp Kërkesën”, që mundëson shkarkimin e kërkesës (shih fig. 6), e cila mund të shtypet pastaj dhe “Kthehuni në listë”, për t’u kthyer tek lista (si në fig. 2).



Kërkesë për shtesë të punëtorëve të ekspozuar ndaj rrezikut

(Sipas Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente - COVID-19)



3-1000000167

Tatimpaguesi

Periudha	<input type="text" value="Prill - Maj 2020"/>	Data e deklarimit	<input type="text" value="19/04/2020 15:10"/>
NUI / NRF	<input type="text" value="601138177"/>		
Emri i tatimpaguesit	<input type="text" value="TEST CORP"/>		
Adresa e tatimpaguesit	<input type="text"/>		
Kodi / Aktiviteti	<input type="text" value="6831 / Agjencitë e patundshmërie"/>		
Personi kontaktues	<input type="text"/>	Telefoni	<input type="text"/>

Punëtorët

	Numri i punëtorëve	Vlera për Kompensim
Punëtor	<input type="text" value="1"/>	<input type="text" value="100.00"/>

Deklarata e tatimpaguesit

DEKLARATA E PUNËDHËNËSIT

- ✓ Deklaroj se biznesi është aktiv gjatë muajve Mars - Prill 2020 dhe ushtron veprimtari afariste, si: dyqan ushqimor dhe/ose furrë buke dhe /ose barnatore.
- ✓ Deklaroj se punëtorët në listën e deklaruar janë në kontakt të drejtpërdrejtë me konsumatorin gjatë ushtrimit të aktivitetit në vendin e tyre të punës.

Figura 6:Kërkesa për pagesë shtesë për punëtorët e ekspozuar ndaj rrezikut, e shkarkuar me shtypjen e butonit "Shtyp Kërkesën"

SHTOJCA 1 – INFORMATA SHITESË

Sipas Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente, personat të cilët do të përfitojnë sipas Masës 7, kërkesat e tyre do t'i dërgojnë përmes Sistemit Elektronik EDI, më së largu deri më 15 maj 2020.

Sipas Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente, gjegjësisht Masës 7, pikës 2.1, jo të gjithë punëtorët e dyqaneve, furrave dhe barnatoreve do të përfitojnë nga kjo shtesë, meqë ajo është e kufizuar në kushtin që punëtori të ketë kontakt të drejtpërdrejt me konsumatorin gjatë punës së bërë.

Andaj, për të përfituar nga kjo masë, punëdhënësi duhet të deklaroj se biznesi është aktiv gjatë muajve Mars - Prill 2020 dhe ushtron veprimtari afariste, si: dyqan ushqimor dhe/ose furrë buke dhe /ose barnatore. Po ashtu, duhet të deklaroj se punëtorët në listën e deklaruar janë në kontakt të drejtpërdrejtë me konsumatorin gjatë ushtrimit të aktivitetit në vendin e tyre të punës.